



Funded by  
the European Union

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

Programi i studimit : MENAXHIM TRANSPORTI DETAR/TOKËSOR

**2-YEAR STUDY PROGRAM Professional Diploma**

Lenda: **OPERATION OF TRANSPORT SYSTEMS- modernize**

Sem. I (I), Year II, elective

viti akademik 2024-2025

**Tema:**

**OBJEKTET E INFRASTRUKTURËS QË PËRDOREN NË TRANSPORTIN E KOMBINUAR  
NË TERMINALE**

Relatoi: Ing Drita HIMA

## OBJEKTET INFRASTRUKTURE PËR PËRDORIM TË TRANSPORTIT TË KOMBINUAR

Në sistemin e kombinuar të transportit mund të konstatohet se në raste të caktuara për- kohësisht vjen deri në ndarje të zinxhirit transportues. Kjo ndodhet zakonisht për shkak të arsyeve teknologjike që ndodhen për shkak të ndryshmit të degës të trafikut gjatë transportit të mallrave deri te marrësi, por edhe për shkak të kapaciteteve të ndryshme të mjeteve transportuese. Për shkak të këtyre arsyeve, dhe që të mund të funksionojë transporti i kombinuar, janë të krijuara objekte infrastrukturore, siç janë: terminalët, stacionet huc- ke-pack, limanet lumore dhe detare, aerodromet etj., përmes së cilave arrihet koordinim në disa dega të qarkullimit.

### STACIONET HUCKE PACK

- Stacionet HUCKE PACK zakonisht ndërtohen në vende ku qarkullojnë mjetet transportuese rrugore, d.m.th., trafiku rrugor dhe hekurudhor. Madhësia dhe formimi i stacioneve, si edhe pajisja e tyre varet nga lloji i manipulimit dhe nga lloji i disa mjeteve transportuese dhe pajisjes. Shumë shpesh stacionet Hucke pack kombinohen me terminale të kontejnerëve, veçanërisht atëherë kur malli ringarkohet nga mjetet transportuese rrugore në makinat hekurudhore dhe anasjelltas, me ndihmë të vinçave portale. Ndryshme, këto stacione ndërtohen në rast kur mjetet

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

transportuese rrugore transportohen me makina hekurudhore (makinë në makinë). Stacionet Hucke pack zakonisht gjenden në qendrat industriale dhe portet.

Këto stacione duhet të kenë në dispozicion numër i mjaftueshëm i binarëve, rrugë vozitëse, hapësirë për qarkullim dhe parkim të makinave rrugore, si dhe me pajisje për- katëse dhe mjete.



Fig. 4.1 Terminali Hucke Pack

## PORTET

Portet janë nyjet e qarkullimit, të cilat sipas pajisjes tekniko-teknologjike, mund të jenë:

- qendra për përqendrim të trafikut të mallrave për shërbim më të gjerë;
- terminale për mallra – transportues me degë të ndryshme të trafikut, trafik dhe organizata tregtare të një rajoni të caktuar;
- amortizuesit për neutralizimin e mosbarazimit për shkak të dallimeve në kapacitet e disa degëve të trafikut, si edhe në plasmanin e mallit për shkak të mospërputhjes së prodhimit dhe konsumit.

Përmes porteve paraqiten mallra masive në forma të ndryshme të mëdha të njësive transportuese-manipulative, për një numër të madh të vendeve, të cilat mund të dedikohen për import, eksport ose transit. Kjo kërkon një shkallë të lartë të përpunimit të mallit që kalon nëpër shumicën e fazave.

Në këtë mënyrë limani luan një rol të rëndësishëm në procesin transportues, duke lidhur degë të ndryshme të qarkullimit në një sistem të vetëm dhe duke formuar në atë mënyrë një zinxhir transportues. Detyrë e portit dhe shkalla e përpunimit të mallit në portin varen nga më shumë faktorë, mes të cilëve më të rëndësishëm janë:

- Objektet infrastrukturore dhe proporcioni i tyre;
- Kapaciteti i disa objekteve dhe kapaciteti i tyre;
- Lloji i qarkullimeve të cilat përfshihen në portin dhe kapaciteti i tyre;
- Lloji dhe sasia e mjeteve të mekanizuara dhe kapaciteti i tyre;

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

- Lloji i mjeteve të transportit (rrugore, hekurudhore, ujore) dhe kapaciteti i tyre;
- Thellësia e ujit (gaz), gjatësia e bregut operativ dhe numri i lidhjeve me to;
- Kushtet dhe mënyra e navigacionit;
- Mënyra e ndjekjes dhe përpunimit të informacioneve dhe
- Rregulloret dhe praktikatat e lidhura me punën e transaksioneve të ndryshme dhe rrjedhjen e formaliteteve limanore dhe trajtimin e mallin.

Duke pasur parasysh numri i madh i komponentëve dhe rëndësia e tyre për punën e por- teve, porti funksionin si një sistem tekniko-teknologjik, duke transformuar punën e mallit nga një në një formë tjetër të transportit.

Limani si një sistem bazohet në zgjidhjen optimale, që merret nga kushtet për ndryshim të gjendjes së sistemit, ku sistemi tejkalon në një në një formë tjetër ose fazë, zhvendoset dhe në lidhje të kësaj formon një sistem i përbërë "Limani si një sistem".



Fig. 4.2 Anija e vendosur në limanin për ringarkim të kontejnerëve

LIMANI SI SISTEM DHE ROLI I TIJ NË SISTEMIN E PËRBËRË TRANSPORTUES



Funded by  
the European Union

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

Limani si një njësi operative, duke pasur parasysh detyra themelore se në kuadër të procesit të transportit kryen një veprimtari të zhvendosjes së mallit nga një mjet transportues në një mjet tjetër, si edhe magazinim i mallit.

Nëse në këtë mënyrë shihen limanet, atëherë mund të supozohet se ato përbëhen nga më shumë nënsisteme, të cilat kanë veprimin e ndërsjellët.

### *PËRCAKTIMI I LIMANIT SI SISTEM*

Limani si një sistem roli i tij në kornizat e procesit të transportit realizon përmes ofrimit të shërbimeve gjatë zhvendosjes së mallit nga një mjet transportues në një mjet tjetër, në të cilat të gjitha objektet janë me qëllimin e definuar qartë, dhe kapaciteti i limanit është i mjaftueshëm për kryerjen e një vargu të operacioneve komplekse.

Faktorët e brendshëm janë në funksion të hartimit të strukturës së sistemit, mes të cilave takojnë objektet të ndryshme dhe kapaciteti i tyre, terminale dhe mjete për manipulim, sisteme për menaxhim me anijet dhe thellësinë e detit etj.

Faktorët e jashtëm janë sistemi transportues dhe kapaciteti i tij, kapacitetet e lëvizshme transportuese nga degë të ndryshme të trafikut, intensiteti i rrjedhjeve të trafikut dhe dinamika e arritjes dhe largimit të mallit.

Të gjithë këta faktorë, të lidhur mes vete, paraqesin një sistem dinamik.

### *INFRASTRUKTURAT E MËDHA LIMANORE*

Për shkak se limani është një sistem i përbërë dhe dinamik, me qëllim qartë i përcaktuar dhe procesi i definuar teknologjik, ai duhet të ketë në dispozicion disa objektet me kapacitete të mëdha. Ndarja dhe emri i këtyre objekteve duhet të jetë sipas formës së tyre dhe funksionit. Duke pasur parasysh këtë, infrastruktura limanore mund të ndahet në disa elemente, dhe ato janë: bregu operativ me një numër të caktuar të trenave, vend ankorimi i anijeve, zona e magazinimit me magazina të mbuluara dhe të hapura, udhë (rrugore dhe hekurudhore), të cilat përshtaten në procesin teknologjik i limanit. Të gjitha këto objekte infrastrukturore janë shumë të shtrenjta, kërkojnë investime të mëdha fillestare, të cilat mund të jenë në dobi vetëm përmes vëllimit të madh të trafikut të mallit dhe në kushte të shkallës së lartë të përpunimit të mallit. Këto objekte të shtrenjta rrisin shumë shpenzimet e shërbimeve të limanit gjatë një vëllimi të vogël të mallit.

### *BREGU OPERATIV*

Një nga objektet e rëndësishme pa të cilat nuk mund të imagjinohet manipulimi i ngarkesës është bregu operativ me mjetet e tij, pajisjes dhe sistemeve të lidhjes. Bregu operativ gjendet midis

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

sipërfaqes ujore dhe tokës si një sipërfaqe operative, e cila duhet të jetë me lloj të hapur dhe e liruar nga një numër i madh i stacioneve dhe objekteve, të cilat do të pengojnë funksionimin e bregut operativ. Për shkak të këtyre arsyeve pozita dhe forma e bregut në lidhje me elementet e tjera ka ndikim i madh mbi kapacitetin dhe xhiron e tyre në një periudhë të caktuar, Duka pasur parasysh këtë, bregu mund të jetë me lloj të ndryshëm.

Lloji (ballor) frontali bregut është më i thjeshtë dhe shumë i madh. Karakterizohet me një hapësirë të gjerë ballore manipulative. Lidhjet me transportin rrugor janë të shpërndara në varg, njëri pas tjetrit që të mundësohet ndryshim i shpejtë dhe i lehtë i anijeve. Ky lloj i bregut është më i përshtatshëm për mallin masiv monoton, sepse mundëson përdorim i mjeteve të ringarkimit të llojit të njëjtë dhe veprimin e tyre përgjatë gjatësisë së bregut.



Fig. 4.3 Lloji ballor i bregut

Lloji i bregut gat<sup>1</sup> është, gjithashtu, shumë i madh dhe konsiderohet si më ekonomik dhe me një rrjedhje më e madhe, por hapja ndaj tokës është e kufizuar. Karakterizohet me rrjedhje më të madhe se sa lloji ballor, sepse mundëson përqendrim dhe vend i stacioneve limano-re dhe mjeteve të ringarkimit përgjatë gjatësisë së bregut. Pastaj, përmban një sistem të tërë të lidhjeve përgjatë gjatësisë së bregut të ringarkimit dhe atë në një hapësirë shumë të kufizuar. Janë të njohura dy lloje, i gjerë – evropian dhe i ngushtë – amerikan. Lloji evropian ka sipërfaqe më të madhe dhe më shumë lidhje me transportin tokësor nga të dyja anët.

Këto brigje janë me kapacitete të mëdha, dhe janë të përshtatshme edhe për manipulim me transportin e përgjithshëm kargo.



Funded by  
the European Union

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860



*Fig. 4.4 Bregu i llojit gat*

<sup>1</sup> Gat është vendi në të cilin lidhen anijet me madhësi të ndryshme në limanin



Funded by  
the European Union

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2  
Project Number: 101082860

### RRUGËT HEKURUDHORE

Limani si një sistem nuk mund të shihet pa infrastrukturë rrugore, e cila shtrihet thellë në limanin. Te limanet e mëdha ekziston një sistem i tërë i rrugëve hekurudhore dhe stacioneve, të cilat janë të lidhura me binarë lidhës të cilët lidhen me limanin. Rrugët hekurudhore gjende në limanin e vetë të bregut operativ dhe bashkë me rrugët marrë-se-dërguese dhe të bashkimit përbëjnë një sistem të tërë. Në vet limanin ekziston një sistem i tërë i rrugëve të ringarkimit, të cilat gjenden në vendet e ringarkimit, shkarkimit ose ngarkimit të mallit. Detyra e rrugëve individuale është e definuar me procesin tek-nologjik të punës së limanit. Megjithatë, proporcioni i këtyre rrugëve është me varësi të madhe të llojit të bregut, veçanërisht nëse duhet të vendosen në një hapësirë të ngushtë, ku vështirë do të sigurohet radiusi i nevojshëm për kurbat e binarëve. Për shkak të kësaj, gjatë ndërtimit të limaneve të reja duhet të kihet parasysh ky faktor. Proporcioni i stacioneve të binarëve varet edhe nga vëllimi i ringarkimit të drejtpërdrejtë, pastaj nga gjatësia e bregut operativ, nga lokacioni i magazinave, mënyra e manipulimit, struktura e ngarkimit etj.

### RRUGËT TOKËSORE

Futja e rrugëve tokësore në lumenjtë ka rëndësinë e njëjtë si edhe futja e rrugëve hekurudhore, sepse sasi e madhe e ngarkimit ende sillen në lumenjtë dhe dërgohet me automjete rrugore. Veçanërisht rrugët tokësore kanë rëndësi të madhe kur përdoret sistem i kombinuar i transportit (RO-RO dhe i kontejnerëve). Transporti i brendshëm limanor, gjithashtu, kërkon rrugë tokësore. Përveç kësaj, rrugët tokësore kanë rëndësi të madhe me lidhjen e rrugëve magjistrale me brendësinë e kontinentit.

Rrugët tokësore mund të ndahen në disa lloje:

- interne,
- eksterne,
- rajonale dhe
- magjistrale

Rrugët *interne* tokësore janë të futura në vet limanin dhe shërbejnë për komunikim të makinave rrugore dhe mjeteve të mekanizuara dhe për shërbim të vendeve manipulative të bregut operativ dhe magazinave.

Rrugët *rajonale* tokësore shërbejnë për lidhjen e limanit me ndërmarrjet më të afërta të cilat shpesh gjenden në zonat bregdetare. Këto rrugë zakonisht gjenden në drejtimin limani – zona industriale dhe limani – rajoni turistik.



Funded by  
the European Union

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

Rrugët *eksterne* ose lidhore formojnë një lidhje të limanit përmes rrugëve rajonale me ato magjistrale, duke u lidhur në atë mënyrë me trafikun e largët me rajonet më të largëta në vendin dhe me zonat gravitacionale jashtë vendit.

*Rrugët magjistrale* mundësojnë shpërndarjen e sasisë më të madhe të malit nga rajonet më të largëta dhe grumbullimin e ngarkesës në limanin e transportit përtej oqeanit.

Me këtë mund qartë të shihet vendi dhe roli i rrugëve tokësore, si edhe nevoja e zhvillimit të vazhdueshëm dhe vendosja e rrugëve tokësore, pa të cilat limanet do të jenë një sistem pjesërisht gjysmë i hapur në zinxhirin transportues.

### MAGAZINAT LIMANORE

Sipas rolit të tyre themelor, magazinat mund të definohen si një hapësirë për të lënë të përkohshme të llojeve të ndryshme të mallit, i cili pas një kohë të caktuar do të përfshihet në shitjen, transportin, shpërndarjen etj. Magazinat limanore mund të kryejnë shumë funksione duke pasur parasysh se gjenden në limanet më të mëdha.

Funksioni i magazinës limanore veçanërisht është i theksuar përmes ringarkimit indirekt ose transferimit të ngarkesës përmes limanit.

Në fakt, kjo del nga dallimet në kapacitetet për transport të degët e caktuara të trafikut, si edhe dallimet në xhiron e rrugëve të cilat përfshihen në limanin dhe bashkë me to përbëjnë një sistem të hapur. Magazinat limanore kanë një ndikim më të madh gjatë përdorimit të infrastrukturës tjetër dhe mjeteve transportuese në eksplotimin. Në këtë mënyrë magazinat veprojnë si një faktor dinamik në lidhjen e degëve të ndryshme të trafikut me prodhimin dhe konsumin, duke kryer në këtë mënyrë dhe funksionin e magazinës publike.



Darryl Bush / The Chronicle

Fig. 4.5 Magazina limanore

#### MEKANIZIMI I RINGARKIMIT SI MJETE PËR PUNË

Stacionet e qëndrueshme si objekte infrastrukturore, bashkë me mekanizimin e ringarkimit dhe mjetet paraqesin një sistem të rrumbullakët dinamik, i cili gjithmonë përmirësohet dhe pasurohet, duke ndërmarrë një seri inovacionesh.

Nga këto arsye mund të thuhet se mekanizimi i ringarkimit, gjithashtu, paraqet një komponent të rëndësishëm, pa të cilin nuk do të mund të imagjinohet funksionimi i limanit si një sistem.

Ringarkimi i ngarkesës në limanin me mekanizim përkatës mund të konsiderohet si një nga nënsistemet e limanit. Nën termin mekanizëm përkatës nënkuptohet një lloj dhe tip i caktuar, në varësi të llojit dhe tipit të njësive transportuese-manipulative, të cilat duhet të manipulohen, d.m.th., zhvendosen.

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2  
Project Number: 101082860



Fig. 4.6 Vinçi lundrues për manipulim të mallit në limanin

Kështu, sot përdoret mekanizimi i ndryshëm, i cili mund të ndahet në mekanizimin breg- detar dhe mekanizimin e anijeve, dhe më tej me atë me veprim i vazhdueshëm dhe veprim me ndërprerje. Mekanizimi mund të ndahet edhe sipas mënyrës së ringarkimit dhe llojit të njëjësive ngarkuese, p.sh., mënyra konvencionale e ringarkimit dhe ringarkim te sistemi transportues racional. Te sistemi transportues racional përdoret mekanizimi i ngarkesës së përgjithshme, masa e së cilës është nga disa tonë deri në disa qindra tonë. Sipas kësaj, mekanizimi i këtillë i ringarkimit kërkon një breg i ndërtuar në mënyrë speciale, përmes së cilit do të lëvizet dhe do të manipulohet vinçi portal me ngarkesë e madhe. Në anijet speciale të futura janë edhe vinça speciale me ngarkesë e ndryshme, si te sistemet e trans- portit LASH, SEABEE, BACAT.

#### TERMINALET "HUCKE PACK" DHE "RO-LA"

Ro-La<sup>2</sup> paraqet një teknologji e transportit të mjeteve të tëra transportuese rrugore me vagonë hekurudhor, emrin e ka marrë nga shkurtesa gjermane që përshkruan këtë tek- nologji e transportit të kombinuar. Derisa teknologjia Huckle Pack është e ndarë në 4 lloje të cilat dallohen me atë që transportohen nga makinat e tëra rrugore deri te teknologjia bimodale.

---

<sup>2</sup> "Rolande straße", nga gjermanishtja "Autostrada rrotulluese"

Makinat te këto dy teknologji ngarkohen me ndihmë të rampave të çelikut ose me ndihmë të mjeteve të mekanizuara manipulative, makinave speciale hekurudhore me dysheme të ulur, me qëllim të mos çrregullohet profili ngarkues i një binar i caktuar. Pasi makinat do të ngarkohen, vozitësi vendoset në

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

vagon për fjetje dhe udhëton bashkë me makinën e tij transportuese në të cilën pushon. Sipas kësaj, kjo teknologji quhet "transport i ndjekur (i shoqëruar)", ndërsa kur bëhet fjalë për lloje të tjera të transportit të kombinuar kur vozitësi nuk udhëton bashkë me makinën e vetë, d.m.th., transportohet vetëm gjysmë-rimorkio ose rimorkio, ajo quhet "transport jo i ndjekur (i pashoqëruar)".



Fig. 4.7 Mënyra e ngarkimit të makinave të tëra rrugore me teknologjinë Ro-La

Lloji i këtillë i transportit përdoret zakonisht për transport të makinave rrugore përmes rajoneve ose vendeve të cilat kanë masa restriktive ekologjike dhe ligjore të cilat kufizojnë lëvizjen e makinave rrugore, siç janë ndalime për lëvizje në një periudhë të caktuar (nga ora 13 deri në orën 19 dhe gjatë vikendeve), taksa të shtrenjta rrugore, taksa të mëdha ekologjike etj. Kufizimet e këtilla janë më të shpeshta në Zvicër, dhe ndoshta për këtë arsye ky lloj transporti më së shumti përdoret për tejkalimin e Alpeve të Zvicrës.



Fig. 4.8 Relacioni më i shpeshtë në të cilin transportohen makinat rrugore me teknologjinë Ro-La

Terminalet paraqesin vende kur bashkohen trafiku rrugor ngarkues dhe hekurudhor, të dedikuara për ringarkim, magazinim dhe lënie të përkohshme të njësive ngarkuese.

Terminali Hucke Pack duhet të pajiset me stacione të caktuara për ringarkim, magazinim, hapësirë e parkingut, por më së shumti varet nga ajo për cilin lloj të teknologjisë Hucke pack është i dedikuar terminali, dhe për të mund të gjenden: rampa të qëndrueshme dhe të lëvizshme, vinça-pirun, vinça të ndryshme, etj.



Funded by  
the European Union

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

Që ka të bëjë me терминалет Ro-La është me rëndësi që të kanë lidhje të shkëlqyeshme me rrugët tokësore dhe të gjenden në drejtimin e lëvizjes së rrjedhjeve ngarkuese në trafikun rrugor, por që ka të bëjë me mjetet për ringarkim, këtu nuk ka nevojë nga investime të mëdha, sepse është e nevojshme vetëm një rampë frontale (e lëvizshme ose fikse).

## MAGAZINAT

Sipas rolit të tyre themelore, magazinat mund të definohen si një hapësirë për magazinim të përkohshëm të llojeve të ndryshme të mallit, që mund të jetë në formë të lëngshme ose në copa, i cili pas një kohë të caktuar do të përfshihet në shitjen, transportin, shpërndarjen ose konsumin. Detyrë e magazinës është që t'i pranojë produktet në fund nga ndonjë proces të prodhimit ose transportit në vende të cilat do të jenë të përshtatshme për magazinim i përkohshëm, dhe prandaj më së shpejti dhe më lehtë do të përfshihen në një nga proceset e lartpërmendura.

Në magazinat, duke pasur parasysh funksionin e tyre themelore, në karakterin e tyre dinamik, bëhet ndryshim i produkteve të magazinimit në një zinxhir të vazhdueshëm. Shikuar nga aspekti i lëvizjes së mallit në zinxhirin prodhimi – transporti – shpërndarja, magazinat kanë një rol absorbues në vende ku ky proces ndërpritet nga cilado arsye. Një rol i veçantë kanë në transportin e kombinuar dhe atë përmes degëve të shumta të trafikut, kur kalohen nga një në një tjetër, për shkak të sinkronizimit të pamjaftueshëm të lëvizjes së mallit dhe kapaciteteve transportuese për shkak të disproporcionit të madh midis kapaciteteve të disa degëve të trafikut.

Në transportin e kombinuar ku marrin pjesë më shumë degë të trafikut, kapaciteti i të cilit transportues më shumë dallohet sipas madhësisë, është mundur në mënyrë racionale që të arrihet një transport i kombinuar vetëm përmes magazinave të caktuara, të cilat janë si amortizues, sepse neutralizojnë këto dallime.

## KLASIFIKIMI I MAGAZINAVE

Sipas karakteristikave të përgjithshme, magazinat mund të klasifikohen sipas kriterëve të mëposhtme:

1. *Sipas formës së mallit*, në magazina me mallin e ambalazhuar dhe e lirshëm, d.m.th., mallin e pakëtuar;
2. *Sipas natyrës së mallit*, në magazina të zakonshme, për produkte të cilat nuk prishen dhe magazina në të cilat rregullohet temperatura, për produkte të cilat mund të prihen lehtë;
3. *Sipas pronësisë së produkteve*, në magazina për nevoja të veta dhe magazina për magazinimin e produkteve të personave të treta, d.m.th., "magazina publike";
4. *Sipas aktivitetit ekonomik*, në magazina bujqësore, magazina industriale, magazina komerciale-distributive, magazina të përgjithshme dhe magazina për nevojat e qarkullimit;
5. *Sipas lokacionit të rampave në degët e trafikut*, në magazina hekurudhore, magazina limanore dhe magazina të brendshme;



Funded by  
the European Union

Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

6. Sipas kritereve teknike të eksploatimit, në magazina të mbuluara, të mbyllura dhe speciale;
7. Sipas mënyrës së magazinimit, në magazina me katin përdhes, magazina na kate dhe magazina manipulative.

Klasifikimi i magazinave, sipas kritereve të paraqitura, lehtëson perceptimin analitik e pro-blemeve në lëvizjen e mallit, pastaj vet magazinimin dhe manipulimet gjatë magazinimit, si edhe roli i disa llojeve të magazinave përmirësojnë koordinimin e degëve të trafikut dhe prodhimit.

### *KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË MAGAZINAVE NË KORNIZAT E RRJETIT TË MAGAZINIMIT*

Duke pasur parasysh funksionin themelor dhe klasifikimin e magazinave, secili nga llojet e lartpërmendura të magazinave ka vendin dhe rolin e tij në kuadër të rrjetit të magazinimit.

Për shkak se magazinat e përgjithshme (e mallrave) shërbejnë për magazinimin e produkteve nga vargu i gjerë, ato kërkojnë edhe teknologji shumë e përbërë dhe mekanizim i ringarkimit. Janë të vendosura në nyjet e trafikut, limanet dhe magazinat hekurudhore, ku lidhin organizatat e prodhimit, transportit dhe shpërndarjes mes vete. Kjo magazinë nuk duhet të lidhet ngushtë vetëm me procesin transportues, por më shumë për t'i zgjidhur problemet tregtare (pabarazia e prodhimit dhe konsumit). Sipas saj, kjo magazinë ka rolin e absorbuesit të luhatjeve, dhe me atë rregullon tregun në dobi të ofertës dhe kërkesës.

Siç magazinat hekurudhore, limanore dhe ato të brendshme kanë një varg të gjerë të mallrave, ashtu edhe magazinat e përgjithshme kanë në dispozicion një varg të gjerë të mallrave. Ato kërkojnë një nivel të lartë teknologjike të mjeteve manipulative për produkte, të cilat duhet të jenë të përbëra dhe të ndryshme. Kërkesat dhe nevojat e këtyre magazinave janë të lidhura më të ngushtë me transportin e kombinuar.

Magazinat për materiale të lirshme, siç janë thëngjilli, koksi, minerali ose koncentrat, kanë një varg të ngushtë të produkteve dhe nuk paraqesin një problem të posaçëm në racionalizimin teknik e eksploatimit të transportit. Kjo zakonisht paraqitet te transporti i kombinuar dhe është i sigurt mekanizimi special, i cili është i përshtatshëm për punë me këto materiale.

Për shkak se magazinat speciale, siç janë p.sh., silose për drithëra dhe çimento, funksioni i tyre është më i dedikuar për magazinimin e materialeve të cilat qarkullojnë në një numër më të madh të degëve të trafikut, janë të vendosura në vende të cilat paraqesin bashkim midis degëve të trafikut me kapacitet më të madh. Përveç kësaj, magazinat kanë edhe një rol si magazina shpërndarëse, dhe veçanërisht siloset, të cilat paraqesin një faktor i rëndësishëm për koordinim midis transportit hekurudhor dhe lumor ose transportit hekurudhor dhe detar. Prandaj, këto objekte zakonisht janë të ndërtuara në limanet, ku takohen më shumë degë të trafikut, dhe më së paku dy.



Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2

Project Number: 101082860

Nga kjo mund të konkludohet se përveç vetive dhe llojit të paketimit të disa llojeve të mallrave, ndikim i madh i xhiros ka edhe organizimi i punës. Përveç kësaj, është e nevojshme që të vendosen një organizim i këtyre i punës që do të sigurojë shfrytëzimin optimal të sipërfaqes dhe vëllimit të magazinës, dhe veçanërisht të pjesës operative, sepse në atë mënyrë kursethet në hapësirë, dhe me atë njëkohësisht ulen edhe shpenzimet nga njësia e punës, d.m.th., manipulimi.

### *ROLI I MAGAZINAVE NË PROCESIN E SHPËRNDARJES*

Qarkullimi i materialeve në çdo formë (lëndë e parë, gjysmë-produkt, produkt përfundimtar), mund të shihet në zinxhirin logjistik, i cili lidh dhe përfshin objektet e ndryshme dhe aktivitete siç janë prodhimi, transporti, magazinimi, qarkullimi, të cilat në fakt paraqesin të mira shpërndarëse nga momenti i nisjes së lëndës së parë deri në momentin e përdorimit të fundit të produktit përfundimtar.

Sipas saj, magazinat gjenden në organizime të ndryshme të trafikut me kërkesa në një periudhë sa mund më të shkurtë ose më të gjatë që të ruajnë mallin deri në momentin e ri-përfshirjes së tij në një proces shpërndarës.

Duke pasur parasysh se këtu bëhet fjalë për rolin e magazinave në procesin e shpërndarjes, i cili është i lidhur me procesin e transportit dhe qarkullimit të mallit, atëherë magazinatat do të trajtohen në atë mënyrë.

Në kornizat e procesit të transportit magazinat paraqiten në sferën e shpërndarjes makro, dhe në pjesët e qarkullimit në sferën e shpërndarjes mikro.

Në kornizat e procesit të transportit nuk ka kufij të mëdhenj midis procesit të prodhimit dhe transportit, që do të thotë se zinxhiri logjistik fillon që nga procesi i prodhimit, dhe përfundon te konsumatori.

Kjo do të thotë se magazinat që gjenden në transportin e brendshëm – që nga sektori i prodhimit, tashmë paraqesin një element të shpërndarjes. Përveç kësaj, janë të domosdoshme magazinat edhe në sferën e transportit nga procesi i shpërndarjes, me çka këto dy sfera plotësohen dhe ndërliken mes vete.

Kërkesat teknologjike të magazinave janë në përputhje me elementet e mëposhtme:

- Njësitë e paletave;
- Njësitë e paketimit;
- Copat e formuara në mënyrë natyrore;



Call: ERASMUS-EDU-2022-CBHE-STRAND-2  
Project Number: 101082860

- Njësiti e dërgesës;
- Kontejnerë të vegjël;
- Kontejnerë të mëdhenj;
- Njësi jo të paketuara të trajtimit;
- Materiale të lirshme;
- Lëngje etj.

Kërkesat e shpërndarjes së këtyre elementeve janë në përputhje me mbartësit e transportit në kornizat e shpërndarjes makro.

Referenca :

“Strategjitë e Transportit Multimodal 2023-2030” - [https://mits.net/repository/docs/2024\\_05\\_13\\_195148\\_STMM\\_SHQIP.pdf](https://mits.net/repository/docs/2024_05_13_195148_STMM_SHQIP.pdf)

“Transporti i kombinuar” (2020) Aleksandar Karakaçanov, Trajçe Shopov, Mr. Gordan Stojiq, Kire Dimanoski

Cikwi Leksionesh – Ing. Drita Hima

*"Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or the European Education and Culture Executive Agency (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them."*